



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Periudha raportuese	<b>Prill 2016</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Ibush Kelmendi, shef i Sektorit

**1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

*-Gjatë muajit raportues janë realizuar detyrat e planifikuara nga zyrtaret e Drejtorisë.*

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.**

1. Mirëmbajtja e ndriçimit publik për vitin 2016, 4 loto;
2. Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e fontanave;
3. Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e semaforëve;
4. Mbikëqyrja dhe ndërtimi i semaforëve dhe laurës në hyrje të parkut "Gërmia";
5. Montimi i shtyllave antiparkim automatike në hyrje të shesheve;
6. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe zonat rurale, 7 loto;
7. Trajtimi i qenve endacakë;
8. Furnizimi me drurë dekorativë për qytet dhe mbjellja e tyre sipas planit dinamik, krasitja dhe prerja e drurëve që paraqesin rrezik;
9. Përgatitja e paramasave për projektet e proceduara për tenderim;
10. Azhurnimi i planit për reagim për territorin e komunës së Prishtinës për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
11. Organizimi i kujdestarisë 24 orë pa ndërprerë në Qendrën për Informim, Alarmim dhe Koordinim.
12. Kontrollimi i radiolidhjeve nëpër bashkësitë lokale rurale;
13. Mbajtja e evidencës të hyrje-daljeve të punëtorëve të Komunës në punë dhe përgatitja e raporteve mujore;
14. Inventarizimi i parkingjeve në disa lagje, rregullimin e komunikacionit në disa pjesë, trajtimin e hapësirave për këmbësorë;
15. Analizat në kuadër të sigurisë në rrugë në afërsi të shkollave dhe institucioneve;

16. Kontrolla e bartjes së mbeturinave nga ana e KRM" Pastrimi";
17. Testimi i sirenavë të sistemit të alarmit publik;
18. Hartimi i raporteve mujore për muajin prill- 2016 për DSHPMSh;
19. Hartimi i planit të veprimit për pastrimin e deponive të egra në territorin e komunës;
20. Propozimvendimi për vlerësim të rrezikut në rrugën "B" dhe për Parkun "Gërmia" për festën 1 Maji;
21. Mbikqyrja e projekteve të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve, realizimi i projektit të shtyllave anti-parkim, modernizimi i semaforëve në përfundim të projekteve, vendosja e numrave ne objekte banesore dhe shtëpitë individuale;
22. Përgatitja e specifikacionit për projektet e sinjalizimit vertikal dhe horizontal të komunikacionit rrugorë, mirëmbajtja e semaforëve, modernizimi i semaforëve, projekti i shtyllave anti-parkim, mbrojtëset e gjelbërimit, pengesat rrugore etj.

**3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

Të gjitha projektet e lartcekura janë në implementim sipas kushteve të kontratës dhe planit dinamik.

1. Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e fontanave;
2. Mbikqyrja dhe shpimi i puseve dhe montimi i pompave;
3. Mbikqyrja dhe mirëmbajtja e semaforëve;
4. Mbikqyrja dhe ndërtimi i semaforëve dhe laurës në hyrje të parkut "Gërmia";
6. Mbikqyrja e montimit të shtyllave antiparkim automatike në hyrje të shesheve;
7. Mbikqyrja e mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe zonat rurale, 7 loto;
8. Trajtimi i qenve endacakë;
9. Përgatitja e paramasave për projektet e proceduara për tenderim;
10. Fillimi i procesit të mbjelljes së drurëve dekorativë për qytet, si dhe luleve sezonale;
11. Vazhdimi i shpërndarjes së shportave për ndarje të mbeturinave nëpër shkolla;
12. Kontrollimi i radiolidhjeve nëpër bashkësitë lokale rurale;
13. Mbajtja e evidencës së hyrje-daljeve të punëtorëve të Komunës në punë, përgatitja e raporteve mujore;
14. Kujdestaria në QIAK funksionon 24 orë pa ndërprerë;
15. Gjatë këtij muaji BPZ ka pasur 128 intervenime;
16. QIAK ka pranuar nga qytetaret dhe institucionet tjera 508 thirrje;
17. Menaxhimi dhe mbikqyrja e kompanive për mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin dimëror që janë në realizim e sipër, dhe atyre për mirëmbajtje verore, që fillon më 15.05.2016;
18. Punimi i 12 kartelave për zyrtarë komunalë;
19. Gjatë këtij muaji nga inspektorët e MSH dhe të preventivës janë lëshuar- 12 njoftime , 13 konstatime, 9 raporte zjarri, 13 pëlqime, 6 procesverbale me masa;
20. Inventarizimi i parkingjeve në disa lagje, rregullimin e komunikacionit në disa pjesë, trajtimin e hapësirave për këmbësorë;
21. Analizat në kuadër të sigurisë në rrugë në afërsi të shkollave dhe institucioneve;
22. Raporti i gjendjeve të rrugëve dhe analizimi i rrugëve nga gropat;
23. Lirimi i trotuareve nga objektet statike dhe vazot;

- Janë krijuar 13,612,90 € të hyra gjatë muajit prill nga shfrytëzimi i hapësirave publike.

#### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.**

1. Mirëmbajtja e ndriçimit publik për vitin 2016, 3 loto;
2. Mirëmbajtja e fontanave;
3. Mirëmbajtja e semaforëve dhe laurës në hyrje të parkut "Germia";
4. Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe zonat rurale, në 7 loto, dhe atyre për mirëmbajtje verore, që fillon me 15.05.2016, 5 loto;
5. Mbikëqyrja e montimit të shtyllave antiparkim automatike në hyrje të shesheve;
6. Trajtimi i qenve endacakë;
7. Furnizimi me drurë dekorativë për qytet dhe mbjellja e tyre, krasitja e drurëve dhe prerje e atyre që paraqesin rrezik;
8. Mbikëqyrja e projekteve që janë në realizim e sipër;
9. Vazhdimësia e zhvillimit të aktiviteteve në mirëmbajtjen e gjelbërimit nga ana e NPK "Hortikultura";
10. Vazhdimësia e fazës së fundit e zhvillimit të aktiviteteve në projektin "Vendosja e shtyllave antiparkim dhe shtyllave mbrojtëse të gjelbërimit në qytetin e Prishtinës";
11. Vazhdimësia e zhvillimit të aktiviteteve në projektin "Zënia dhe trajtimi i qenve endacakë në qytetin e Prishtinës";
12. Vazhdimësia e zhvillimit të aktiviteteve në projektin "Mirëmbajtja e puseve dhe pajisjeve";
13. Plani komunal për mbrojtje nga zjarri-azhurnimi i tij;
14. Formimi i këshillave administrativë në banesat në bashkëpronësi;
15. Testimi i sirenave të sistemit të alarmit publik.

##### **4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese**

Në bazë të realizimit të punëve për muajin prill janë proceduar për pagesë: 60,627.83 €.

##### **4.1.3 Takimet me palë**

Takimet me palë janë pjesë e procesit të punëve të përditshme, të cilat realizohen në bazë të shqyrtimit të kërkesave që kanë të bëjnë me:

- Zgjerim dhe mirëmbajtje të ndriçimit;
- Problemeve të ndryshme që paraqiten në rrugë, hapësira publike, kanalizim, mbeturina etj.
- Shfrytëzim të hapësirës publike;
- Kërkesa të ndryshme për transport, shenja komunikacioni, parkingje;
- Gjatë këtij muaji zyrtarët e sektorit kanë pasur 197 takime me palë.

#### **5. Takimet me institucione të tjera**

Takim me MMPH – Divizioni për mbeturina.

MPB, MAPL, OSCE, Kryqi i kuq komunal, UNDP, MMPH, GIZ dhe DEMOS, PK.

## **6. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë**

- Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur diskutime publike.

### **6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare**

- Gjatë këtij muaji s'ka pasur kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

### **6.1.2 Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër.**

- Janë pranuar 270 lëndë gjatë këtij muaji, prej tyre janë realizuar 167, ndërsa 103 janë në realizim e sipër, prej tyre janë (110 njoftime, 38 konstatime dhe pëlqime, 18 vendime, 1(një) e refuzuar).

### **6.1.3 Takime të tjera**

- Takimet me kompani KUR "Prishtina", KEDS, PTK, IPKO, KFOR, Kryqi i Kuq komunal.

## **7. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.**

Gjatë realizimit të projektit "Vendosja e shtyllave antiparkim dhe shtyllave mbrojtëse të gjelbërimit" si dhe gjatë realizimit të punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara, në terren kemi hasur në probleme nga parkimi i automjeteve në vendet ku është dashtë të realizohen punët;

**REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.**

## **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues**

- 1.Mbikqyrja e realizimit të kontratave të cekura më lart;
- 2.Punimi i projektit për mirëmbajtjen fontanave dhe krojeve;
- 3.Riparimi i ashensorëve, faza VIII;
- 4.Ndriçimi i varrezave për komunitete;
5. Zgjerimi i ndriçimit publik për vitin 2016;
6. Mbjellja e luleve sezonale dhe drurëve dekorativë në qytet-vazhdim;
7. Furnizimi me shporta për ndarje të mbeturinave të riciklueshme në objektet komunale;
- 8.Furnizimi me kontejnerë 1.1 m<sup>3</sup> dhe kosha 240l;
9. Riparimi i ashensorëve;
10. Kontrollimi i radiolidhjeve nëpër bashkësitë lokale rurale;
- 11.Mbajtja e evidencës të hyrje-daljeve të punëtorëve të Komunës në punë, përgatitja e raporteve mujore;
- 12.Verifikimi i funksionimit të sistemit të alarmimit në qytet;
- 13.Azhurnimi i planit komunal për mbrojtje nga zjarri;
- 14.Mbikëqyrja e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve dhe verore, që fillon më 15.05.2016;

15. Përgatitja e shënimeve për performancë komunale - komulative të 15 shërbimeve komunale për periudhën 2009-2015, si dhe adresimi në MAPL;
16. Inspektimi i disa shkollave në territorin e komunës nga aspekti i mbrojtjes;
17. Përfundimi i projektit "Vendosja e shtyllave antiparkim dhe shtyllave mbrojtëse të gjelbërimit në qytetin e Prishtinës";
18. Pastrimi i deponive të egra me rastin e ditës së tokës dhe aksionit "Ta pastrojmë Kosovën", më 24 maj dhe më 09.05.2016 për nder të Ditës së Evropës;
19. Përgatitja e planit zbatues për parkingjet publike;
20. Realizimi i kontratave nga pika 1-5;
21. Punimi i projekteve sipas vijës buxhetore në fusha të ndryshme.

**8. TË TJERA - Shënimi çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.**

Përgatitja për fillimin e revitalizimit – rregullimit të hapësirave të degraduara në qytet sipas planit të përpiluar nga DSHPMSh.

Organizimi i aksionit për pastrimin e deponive të egra në territorin e komunës, për nder të Ditës së Tokës.

Organizimi i tryezës së rumbullakët me MPB ,ICITAP,KKSB.EVSB dhe KLSP, me temën "Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm në shoqëri".

Plani i veprimit për festën 1 Maji në parkun "Gërmia".